



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0402

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE MEDPLUS SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së” me numër të prokurimit 635-26-957-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES, më 05.08.2026, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet si pjeserisht e bazuar** ankesa e MEDPLUS SH.P.K., me nr. 2026/0402, e datës 20.06.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së”, me numër të prokurimit 635-26-957-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E PEJES.
2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E PEJES për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së”, me numër të prokurimit 635-26-957-1-1-1.
3. Të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.03.2026 KOMUNA E PEJES, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit prokurimit “Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së”, me numër të prokurimit 635-26-957-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 250,000.00€.

Me 05.06.2026 KOMUNA E PEJES, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin e AK (B58), ku është anuluar aktiviteti i prokurimit.

Me 10.06.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 11.06.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20.06.2026, OEMEDPLUS SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0402, duke e atakuar Vendimin për anulim të aktivitetin e prokurimit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues MEDPLUS SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Me datë 05.06.2026, përmes platformës elektronike e-Prokurimi, kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK), me të cilin është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa ne kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderues të Eliminuar, me arsyetimin si më poshtë:

Ju sqarojmë se arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar, ndërsa kundërshtimin e eliminimit e argumentojmë me faktet si në vijim:

1. Arsyeja e parë e eliminimit, se kinse kemi ofruar çmime dukshëm më të ulëta në krahasim me vlerën e parashikuar, është e paargumentuar, pasi që ne kemi ofertuar fillimisht brenda vlerës së parashikuar dhe me çmime të cilat janë në përputhje me Ligjin për Çmimin e Produkteve Medicinale. Në dispozitën e nenit 14, paragrafi 1, të këtij ligji specifikohet qartë se: "Bazë për përcaktimin e çmimit të blerjes apo të rimbursimit të produkteve medicinale nga ana e institucioneve publike, sipas kompetencës përkatëse për kontraktim të produkteve medicinale, do të jetë Lista Zyrtare e Çmimeve me Shumicë të Produkteve Medicinale e publikuar nga Ministria."

Ne kemi ofertuar me çmime që janë brenda parashikimeve të Listës Zyrtare të Çmimeve, prandaj arsyeja e eliminimit është plotësisht në kundërshtim me Ligjin për Çmimin e Produkteve Medicinale, si dhe me nenin 61 të LPP-së.

Sa i përket realizueshmërisë së kontratës me këto çmime, për të cilat AK-ja pretendon se ka dyshime, sqarojmë se, nëse ka pasur dyshime, ajo ka mundur të kërkojë një siguri shtesë, siç është rritja e sigurimit të ekzekutimit të kontratës. Megjithatë, autoriteti kontraktues nuk ka argumentuar në asnjë mënyrë arsyen e eliminimit. Si dëshmi se kompania jonë është serioze dhe do ta përfundojë kontratën, shërben edhe kontrata paraprake të cilën e kemi realizuar me këtë

autoritet kontraktues, me përkushtim maksimal dhe në përputhje me kushtet kontraktuale.

Ne jemi të sigurt dhe të bindur se mund ta realizojmë kontratën me këto çmime dhe jemi në gjendje të argumentojmë mënyrën e realizimit, si dhe të garantojmë, në çfarëdo forme dhe mënyre, realizueshmërinë e kësaj kontrate.

Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar dispozitën e nenit 61.1 të LPP-së, pasi nuk ka kërkuar fare sqarime për çmimet e ofruara nga ne. Ndërkohë, kjo dispozitë përcakton se, nëse një tender duket se përmban çmime jonormalisht të ulëta, autoriteti kontraktues duhet ti dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit, duke kërkuar: (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime lidhur me bazën e tenderit, sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Pra, autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar procedurën ligjore të paraparë për çmimet jonormalisht të ulëta dhe, për rrjedhojë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin kur na ka eliminuar nga konkurrenca. Për më tepër, ka vepruar në mënyrë arbitrare, pasi që një operator ekonomik nuk mund të eliminohet pa iu kërkuar paraprakisht sqarime.

2. Arsyeja e dytë e eliminimit lidhet me faktin se kemi ofertuar produktin "AHD 2000 G Hygienic and Surgical Hand Disinfectant", i cili, sipas etiketës dhe të dhënave të prodhuesit, përmban 75 g etanol në 100 g produkt, përkatësisht 75%. Sqarojmë se ne kemi ofertuar me produkt ekuivalent, ndërsa ekuivalenca për këtë produkt është lejuar edhe nga Paneli Shqyrtues me Vendimin nr. 186/26, datë 21.04.2026.

Pretendimi i AK-së se produkti i ofruar nuk përmbush kërkesën minimale dhe nuk paraqet specifikim ekuivalent apo më të avancuar është i paqëndrueshëm dhe i paargumentuar. Ne e konfirmojmë dhe e argumentojmë ekuivalencën edhe përmes ekspertizës së ekspertit gjyqësor – Farmacist, Specialist i Toksikologjisë dhe Barnave, z. Nardi Sh. Sheqerxhiu, të cilin e kemi angazhuar pas pranimit të Letrës Standarde për Tenderues të Eliminuar. Ai ka analizuar kërkesat dhe specifikat për produktin nr. 68 të dosjes së tenderit, duke i krahasuar ato me specifikat e produktit që kemi ofertuar.

Eksperti profesional gjyqësor, në ekspertizën e datës 08.06.2026, ka konstatuar si më poshtë:

Bashkëngjitur gjeni ekspertizën në fjalë.

Nga kjo ekspertizë profesionale rezulton se produkti i ofruar nga ne është i barasvlershëm (ekuivalent), si në aspektin teknik ashtu edhe në atë funksional, me produktin e kërkuar. Prandaj, rezulton se jemi eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet i prokurimit dhe kërkojmë që ky vlerësim të korrigjohet, duke u rekomanduar për dhënie të kontratës.

Nuk është e saktë shkencërisht se një përmbajtje më e lartë e etanolit nënkupton automatikisht efektivitet më të lartë dezinfektues.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues se produkti i ofertuar me 75 g etanol/100 g nuk paraqet specifikim ekuivalent apo më të avancuar në raport me kërkesën prej 89.1 g etanol/100 g, duke pretenduar se përmbajtja e etanolit është elementi thelbësor për efektivitetin e produktit dezinfektues, është i paargumentuar dhe i pambështetur në evidencë shkencore. Gjithashtu, nuk demonstroi në asnjë mënyrë se koncentrimi prej 89.1 g/100 g siguron efektivitet superior ndaj produktit të ofertuar me 75 g/100 g.

Përveç ekspertizës së bashkëngjitur, edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH/WHO) rekomandon formulime me 60–80% etanol për dezinfektim.

Bashkëngjitur gjeni edhe udhërrëfyesin e OBSH-së.

Po ashtu, literatura shkencore konstaton se koncentrimet shumë të larta të alkoolit nuk janë domosdoshmërisht më efektive, pasi prania e ujit është e nevojshme për denaturimin e proteinave mikrobike dhe për rritjen e kohës së kontaktit.

Për rrjedhojë, autoriteti kontraktues nuk ka provuar me asnjë analizë teknike, laboratorike apo referencë shkencore se produkti me 75 g/100 g etanol nuk arrin të njëjtin rezultat dezinfektues ose se është inferior në performancë ndaj produktit me 89.1 g/100 g etanol.

Bashkëngjitur gjeni WHO Guidelines on Hand Hygiene in Health Care, ku në faqen 32 specifikohet se tretësirat me alkool 60–80% janë më efektive, ndërsa koncentrimet më të larta janë më pak potente.

Pra, si nga ekspertiza, ashtu edhe nga dëshmitë shkencore të lartcekura dhe rekomandimet e OBSH-së, rezulton se produkti ynë, me përbërjen që posedon, është madje më efikas se produkti me përbërjen e kërkuar. Për rrjedhojë, arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është i pabazuar, i paqëndrueshëm dhe i pambështetur në ndonjë provë, dëshmi shkencore apo ekspertizë profesionale.

Autoriteti kontraktues, në këtë aktivitet të prokurimit, ka vepruar në mënyrë tendencioze, me qëllimin e vetëm që të na eliminojë nga aktiviteti i prokurimit dhe ta anulojë këtë tender, pasi ka parë se nuk ka arritur ta shpërblejë me kontratë operatorin ekonomik të favorizuar, i cili kishte gabime substanciale, duke mos ofruar deklaratën nën betim dhe deklaratën për themelimin e grupit, pra duke qenë administrativisht i papërgjegjshëm.

Grupi i operatorëve ekonomikë të eliminuar "BRT Pharm SHPK & NSHT Neramed" ka ofruar çmime tej normalisht të larta dhe mbi çmimet e përcaktuara me Ligjin për Çmimin e Produkteve Medicinale, pra mbi tavanin e lejuar me këtë ligj. Çmimet e përcaktuara me këtë ligj janë çmime të tregut, të analizuara nga ekspertë dhe hulumtues të çmimeve të barnave dhe produkteve medicinale.

Për shembull:

Çmimi i alkoolit është ofertuar 8 euro, ndërsa në treg gjendet rreth 1.50 euro.

Çmimi i dorëzave është ofertuar 7 euro, ndërsa në treg gjendet rreth 2.50 euro.

Çmimi për Hyoscine Butylbromide është ofertuar mbi çmimin zyrtar të Listës së Çmimeve.

Po ashtu, edhe çmimi për Glucose 5% 500 ml është ofertuar mbi çmimin zyrtar të Listës së Çmimeve.

Bashkëngjitur gjeni Listën Zyrtare të Çmimeve të Produkteve Medicinale të Rideklaruara 2026, nga e cila shihet se grupi i operatorëve ekonomikë "BRT Pharm SHPK & NSHT Neramed" ka ofertuar me çmime mbi tavanin e lejuar me ligj.

Autoriteti kontraktues nuk është dashur të bëjë krahasimin e çmimeve ndërmjet kompanive, pasi ky nuk është një krahasim real. Krahasimi real është ai ndërmjet çmimit të ofertuar dhe çmimit të tregut, ndërsa në këtë rast krahasimi më objektiv është ai me Listën Zyrtare të Çmimeve të Produkteve Medicinale të Rideklaruara 2026.

Kur bëhet ky krahasim, rezulton se ne kemi ofertuar brenda kësaj kornize të çmimeve, ndërsa grupi i operatorëve ekonomikë "BRT Pharm SHPK & NSHT Neramed" ka ofertuar me çmime mbi tavanin e lejuar me ligj. Këto dëshmi konfirmojnë se ne kemi ofertuar me çmime reale, në përputhje me tregun dhe brenda kornizës së çmimeve të përcaktuara nga shteti.

Autoriteti kontraktues, në vend që të kursejë buxhetin e shtetit dhe të stimulojë respektimin e ligjeve, përfshirë edhe Ligjin për Listën Zyrtare të Çmimeve të Produkteve Medicinale të Rideklaruara 2026, ka vepruar në mënyrë të kundërt, duke na eliminuar pa bazë ligjore dhe duke rrezikuar dëmtimin e buxhetit publik.

Me datë 11.05.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se ajo është e pabazuar. Megjithatë, në asnjë pjesë të këtij vendimi nuk është paraqitur ndonjë dëshmi konkrete me të cilën do të argumentohet ose provohej e kundërta e pretendimeve tona ankimore.

AK-ja, sa i përket pretendimit tonë ankimor lidhur me arsyen e eliminimit tonë, është përgjigjur si në vijim:

Kjo përgjigje e AK-së është subjektive dhe pa ndonjë mbështetje konkrete ligjore.

Nuk mund të eliminohet një operator ekonomik mbi bazën e dyshimeve kinse serioze, siç e paraqet gjendjen autoriteti kontraktues, sepse dyshimet në këtë rast janë tërësisht subjektive dhe të pambështetura në argumente faktike apo ligjore.

Autoriteti kontraktues nuk ka shprehur fare interesim për të kërkuar sqarime, ashtu siç e obligojnë neni 61 i LPP-së dhe neni 41 i Rregullores së Prokurimit Publik nr. 001/2022. Përkundrazi, autoriteti kontraktues ka supozuar dhe ka imagjinuar, sipas vlerësimit të tij subjektiv, aftësinë tonë për realizimin e kësaj kontrate. Ky veprim i AK-së është arbitrar dhe tendencioz.

Nga ana e autoritetit kontraktues është bërë një interpretim i gabuar, i njëanshëm dhe subjektiv i nenit 61 të LPP-së, pasi kjo dispozitë nuk lejon eliminimin e një operatori ekonomik për çmime jonormalisht të ulëta pa i kërkuar paraprakisht sqarime shtesë. Prandaj, veprimet e AK-së janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me këtë dispozitë.

Në lidhje me pretendimin nr. 2, AK-ja ka dhënë këtë përgjigje:

Edhe nga kjo përgjigje kuptohet se AK-ja ka analizuar vetëm vlerat numerike dhe sasinë, por jo përmbajtjen dhe përbërjen e produktit nr. 68, duke mos e marrë fare parasysh ekuivalencën.

Gjithashtu, nuk është marrë në konsideratë ekspertiza e ekspertit gjyqësor, e as argumentet shkencore që i kemi paraqitur në kërkesën për rishqyrtim.

Ne nuk kemi kërkuar heqjen, ndryshimin apo modifikimin e ndonjë kriteri gjatë procesit të vlerësimit të tenderit, siç pretendon AK-ja. Përkundrazi, kemi kërkuar që të merret parasysh

ekuivalenca dhe që të analizohet në substancë përbërja e produktit, jo vetëm nga aspekti sasior, por edhe nga aspekti cilësor dhe kualitativ.

Sa i përket ekuivalencës, OSHP-ja e ka lejuar atë me vendimin përkatës, mirëpo autoriteti kontraktues nuk e ka përfillur këtë vendim. Për këtë arsye, duhet të zbatohet vendimi i OSHP-së dhe të merret parasysh përbërja ekuivalente e produktit që ne kemi ofertuar.

Pretendimi i AK-së se në këtë tender nuk ka operator ekonomik të favorizuar është i paqëndrueshëm, sepse pikërisht grupi i operatorëve ekonomikë "BRT Pharm SHPK & NSHT Neramed" është favorizuar me anulimin e këtij tenderi, pasi i është krijuar mundësia për të konkurruar përsëri në një procedurë të ardhshme, ndonëse në këtë aktivitet të prokurimit ka qenë administrativisht i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet e paraqitura më lart, rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, si dhe nuk është respektuar kriteri kryesor për dhënien e kontratës, që ishte përzgjedhja e tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët, në përputhje me nenin 60, paragrafi 1.1, të LPP-së.

Nga faktet e lartcekura kuptohet se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, pasi ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe nuk është plotësuar asnjë prej kushteve të përcaktuara në këtë dispozitë për anulimin e tenderit.

Gjithashtu, nuk është plotësuar asnjë prej kushteve të përcaktuara në nenet 43.5 dhe 43.7 të Rregullores së Prokurimit Publik nr. 001/2022 për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së parashih qartë se: "Autoriteti kontraktues do ti trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente." Megjithatë, AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë, pasi ne jemi eliminuar dhe diskriminuar pa ndonjë bazë ligjore, duke mos u rekomanduar për dhënie të kontratës.

Po ashtu, nuk është marrë në konsideratë as neni 1 i LPP-së, duke qenë se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, si dhe të të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

1. Mbi pretendimin për çmimin abnormalisht të ulët

Parashtruesi pretendon se eliminimi për çmim abnormalisht të ulët është i paqëndrueshëm, ngase ka ofertuar brenda vlerës së parashikuar dhe brenda kornizës së Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale, duke iu referuar nenit 14, paragrafi 1, të këtij ligji, sipas të cilit baza për përcaktimin e çmimit është Lista Zyrtare e Çmimeve me Shumicë e publikuar nga Ministria. Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë pretendim juridikisht të pabazuar.

Lista Zyrtare e Çmimeve, në kuptim të dispozitës së lartcekur, përcakton tavanin maksimal të çmimit të blerjes së produkteve medicinale; ajo nuk paraqet as garanci dhe as dëshmi se një ofertë konkrete është ekonomikisht e realizueshme. Përmbushja e tavanit dhe abnormaliteti i çmimit janë dy çështje krejtësisht të ndara: e para ka të bëjë me kufirin e sipërm ligjor të çmimit, ndërsa e dyta me realizueshmërinë e kontratës dhe mbulimin e kostove reale të furnizimit. Prandaj, fakti që parashtruesi ka ofertuar nën tavanin e Listës Zyrtare nuk e përjashton

mundësinë që oferta e tij të jetë abnormalisht e ulët dhe as nuk e zëvendëson vlerësimin që Autoriteti Kontraktues është i detyruar ta bëjë sipas nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Në rastin konkret, oferta financiare e parashtruesit prej 120.42 € paraqet një devijim prej rreth 78.37% nën vlerën e parallogaritur prej 556.22 €. Ky devijim i theksuar është konstatuar nga Komisioni Vlerësues jo në mënyrë të përgjithshme, por duke analizuar çmimet pozicion për pozicion dhe duke i krahasuar ato me çmimet referuese të tregut për produkte me karakteristika të njëjta ose të ngjashme. Një devijim i kësaj përmase ngre dyshime serioze dhe objektive lidhur me aftësinë e operatorit për të furnizuar sipas specifikimeve të kërkuara dhe për të mbuluar kostot reale, gjë që, sipas nenit 61 të LPP-së, i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën ta refuzojë ofertën si abnormalisht të ulët.

As propozimi i parashtruesit se Autoriteti Kontraktues mund të kërkonte një siguri shtesë të ekzekutimit nuk e ndryshon këtë përfundim. Neni 61 i LPP-së i njeh Autoritetit Kontraktues të drejtën, e jo detyrimin, që ta refuzojë një ofertë abnormalisht të ulët, ndërsa asnjë siguri shtesë nuk e eliminon mospërputhjen teknike që oferta e parashtruesit paraqet në pozicionin 68. Edhe sikur çështja e çmimit të anashkalohej tërësisht, oferta do të mbetej e papërgjegjshme për shkaqe teknike.

Po ashtu, referimi në një kontratë të mëparshme të realizuar me Autoritetin Kontraktues nuk ka peshë juridike në këtë procedurë, ngase çdo ofertë vlerësohet vetëm sipas kushteve dhe kriterëve të kësaj Dosjeje të Tenderit.

2. Mbi pretendimin për ekuivalencën e produktit në pozicionin 68

Parashtruesi pretendon se produkti i ofruar "AHD 2000 G", me 75 g etanol në 100 g, është ekuivalent me kërkesën prej 89.1 g, se ekuivalenca është lejuar me Vendimin e Panelit Shqyrtues nr. 2026/0186 dhe e mbështet këtë qëndrim me ekspertizën e datës 08.06.2026, si dhe me udhërrëfyesin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh). Autoriteti Kontraktues e ka shqyrtuar me kujdes këtë argumentim, mirëpo ai nuk e rrëzon qëndrimin e shprehur në letrën e eliminimit.

Dosja e Tenderit, e korrigjuar pikërisht në zbatim të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0186, përmes Formularit B54 të datës 23.04.2026, përcakton për pozicionin 68 së paku 89.1 g etanol 96% në 100 g tretësirë si kërkesë minimale të pranueshmërisë. Shënimi se specifikat janë minimale dhe se mund të ofertohej me specifikacion më të mirë nuk e zbut, por e forcon këtë kufi. Kjo do të thotë se operatori ekonomik mund të ofrojë një produkt ekuivalent ose superior, me kusht që ai ta përmbushë ose ta tejkalojë minimumin e përcaktuar. Një përmbajtje prej 75 g në 100 g qëndron nën këtë minimum dhe, për vetë natyrën e saj, nuk mund të konsiderohet as ekuivalente e as më e avancuar se kërkesa, ngase është sasiore më e ulët.

Ligjshmëria e këtij specifikimi tashmë është çështje e gjykuar. Parashtruesi i ka kontestuar dy herë kërkesat teknike për pozicionet 68 dhe 69: së pari me ankesën nr. 2026/0186, e cila u aprovua pjesërisht dhe e detyroi Autoritetin Kontraktues të lejonte ekuivalencën, detyrim të cilin Autoriteti e zbatoi përmes korrigjimit të Dosjes së Tenderit; dhe më pas me ankesën nr. 2026/0284, ku pretendoi se përcaktimi i vlerës 89.1 g favorizon një prodhues të caktuar.

Me Vendimin nr. 2026/0284, Paneli Shqyrtues i OSHP-së e refuzoi këtë ankesë si të pabazuar, duke konfirmuar se Autoriteti Kontraktues e kishte zbatuar vendimin paraprak dhe se specifikat

janë minimale, duke lejuar ofertimin me produkt ekuivalent ose më të avancuar. Ky vendim është përfundimtar.

Rrjedhimisht, parashtruesi nuk mund ta rihapë në fazën e vlerësimit ligjshmërinë e një specifikimi që nuk arriti ta përmbushë, e aq më pak të kërkojë që Autoriteti Kontraktues të pranojë një produkt nën minimumin e konfirmuar nga vetë OSHP-ja.

Sa i përket ekspertizës së pavarur dhe referencës në udhërrëfyesin e OBSH-së, ato nuk e ndryshojnë gjendjen faktike e as juridike. Pavarësisht përmbajtjes së tyre, asnjëra prej tyre nuk e vërteton elementin vendimtar, përkatësisht se produkti i ofruar e përmbush kërkesën minimale prej 89.1 g etanol 96% në 100 g, të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Specifika e kërkuar nuk është përmbushur dhe Autoriteti Kontraktues nuk mund të dalë jashtë kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe të konfirmuara me vendimin e OSHP-së.

Për më tepër, neni 40 i Rregullores për Prokurimin Publik ndalon shprehimisht ndryshimin, modifikimin apo heqjen e kritereve të përcaktuara paraprakisht gjatë fazës së vlerësimit. Pranimi i një produkti me përmbajtje nën 89.1 g/100 g do të përbënte ndryshim të paligjshëm të kriterit dhe trajtim jo të barabartë ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë.

3. Mbi pretendimin për favorizim, diskriminim dhe çmimet e operatorit tjetër

Parashtruesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë tendencioze, me qëllimin e vetëm që ta eliminojë atë dhe ta anulojë tenderin, pasi nuk arriti ta shpërblejë me kontratë një operator të favorizuar. Gjithashtu, ai pretendon se Grupi i Operatorëve Ekonomikë "BRT Pharm SH.P.K. & N.SH.T. NERAMED" ka ofertuar me çmime mbi tavanin e përcaktuar me Ligjin për Çmimin e Produkteve Medicinale. Të dyja këto pretendime bien në kundërshtim me vetë gjendjen faktike të lëndës.

Në radhë të parë, nuk ekziston asnjë operator i favorizuar dhe nuk është dhënë asnjë kontratë. Grupi i Operatorëve Ekonomikë "BRT Pharm SH.P.K. & N.SH.T. NERAMED" është eliminuar gjithashtu nga procedura, si ofertë administrativisht e papërgjegjshme, për shkak të mungesës së Deklaratës nën Betim të N.SH.T. NERAMED dhe të Marrëveshjes së Grupit të Operatorëve Ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues nuk i ka dhënë kontratë asnjë operatori ekonomik, por ka anuluar të gjithë aktivitetin e prokurimit, çka është pikërisht e kundërta e favorizimit që pretendohet. Trajtimi i barabartë, i kërkuar nga neni 7 i LPP-së, është respektuar plotësisht, pasi të dy operatorët ekonomikë janë vlerësuar sipas të njëjtave kritere të Dosjes së Tenderit dhe të dy janë eliminuar për mospërmbushje reale të kërkesave.

Në radhë të dytë, vetë pretendimi se operatori ekonomik konkurrent ka ofertuar mbi tavanin ligjor, edhe nëse do të merrej si i mirëqenë, nuk e ndihmon parashtruesin, por, përkundrazi, e përforcon konstatimin e Autoritetit Kontraktues se në këtë procedurë nuk ka mbetur asnjë ofertë e përgjegjshme, gjë që e mbështet anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe nuk e rrëzon atë.

Sidoqoftë, vlerësimi i ofertës së një operatori tjetër ekonomik nuk e bën të përgjegjshme ofertën e vetë parashtruesit, e cila është refuzuar drejtdisht në dy baza të pavarura. Për këtë arsye, parashtruesi nuk ka interes juridik për ta kontestuar mënyrën se si është vlerësuar oferta e operatorit tjetër.

4. Mbi ligjshmërinë e anulimit të aktivitetit të prokurimit

Parashtruesi pretendon se nuk janë plotësuar kushtet e nenit 62 të LPP-së dhe të nenit 43 të Rregullores për Prokurimin Publik për anulimin e aktivitetit të prokurimit, pasi, sipas tij, ai është ofertues i përgjegjshëm dhe kriteri i tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët është anashkaluar. Ky pretendim mbështetet në një premisë të rreme dhe, për pasojë, bie bashkë me të.

Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, në përputhje me nenin 59 të LPP-së, Komisioni Vlerësues konstatoi se asnjëra nga dy ofertat e dorëzuara nuk është e përgjegjshme. Oferta e parashtruesit u vlerësua si e papërgjegjshme për shkak të çmimit abnormalisht të ulët dhe mospërputhjes teknike në pozicionin 68, ndërsa oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomikë "BRT Pharm SH.P.K. & N.SH.T. NERAMED" u vlerësua si e papërgjegjshme për shkak të mungesës së dokumenteve obligative.

Kriteri për dhënien e kontratës, sipas nenit 60 të LPP-së, përkatësisht çmimi më i ulët, zbatohet vetëm ndërmjet ofertave të përgjegjshme. Në mungesë të një oferte të përgjegjshme, ky kriter nuk mund të zbatohet dhe, rrjedhimisht, kontrata nuk mund të jepet.

Në këto rrethana, anulimi i aktivitetit të prokurimit, në mbështetje të nenit 62 të LPP-së dhe nenit 43 të Rregullores për Prokurimin Publik, nuk është vetëm i ligjshëm, por përbën edhe zgjidhjen e vetme të mundshme ligjore.

Meqenëse oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme, premisa se ai është "ofertues i përgjegjshëm" nuk qëndron dhe, për rrjedhojë, nuk qëndron as pretendimi se kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk kanë qenë të plotësuara.

Larg nga të qenit në kundërshtim me qëllimin e ligjit, anulimi i aktivitetit të prokurimit i shërben pikërisht këtij qëllimi. Neni 1 i LPP-së synon shfrytëzimin më efikas, më transparent dhe më të drejtë të fondeve publike. Ky qëllim mbrohet duke mos i dhënë kontratë as një oferte abnormalisht të ulët, e cila ngre dyshime serioze për realizueshmërinë e saj dhe nuk i përmbush specifikimet teknike, e as një oferte administrativisht të papërgjegjshme.

Në fund, edhe kërkesa e parashtruesit për kompensimin e dëmeve materiale në vlerë prej 5,000.00 € është e pabazuar, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka kryer asnjë veprim të kundërligjshëm. Për më tepër, sipas vetë Dosjes së Tenderit, të gjitha shpenzimet për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës bartën nga tenderuesi, ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk ka asnjë detyrim për kompensim në rast të anulimit të procedurës.

Konkluzion

Duke u mbështetur në sa u parashtrua më sipër, Autoriteti Kontraktues konstaton se të gjitha pretendimet ankimore të OE MEDPLUS SH.P.K. janë të pabazuara.

Oferta e parashtruesit është refuzuar drejtësisht mbi dy baza të pavarura, secila prej tyre e mjaftueshme dhe vendimtare për refuzimin e saj. Specifikimet teknike janë të ligjshme dhe të konfirmuara me vendim përfundimtar të OSHP-së, ndërsa mungesa e çdo oferte të përgjegjshme e bën anulimin e aktivitetit të prokurimit të ligjshëm dhe të detyrueshëm.

Prandaj, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 24.06.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0402, ndërsa me datë 13.07.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0402, me rekomandimet si në vijim Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësit dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEMEDPLUS SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0402 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59 dhe 61 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues është njoftuar nga autoriteti kontraktues me Vendimin (B58), ku AK e anulon në tërësi aktivitetet e prokurimit Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së. OE ankues eliminohet me arsyetimin se cmimet e ofruara janë abnormalisht të uleta dhe arsyeja e dyte e eliminimit ka të bëjë me specifikimet teknike të produktit.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyetimin e pare të eliminimit të autoritetit kontraktues, vlereson se nuk qendron, sepse nuk mund të merret parasysh dhe të krahasohet vlera e parashikuar me cmimin e ofruar për një ose disa produkte. Në rastin konkret AK ka deklaruar se për 69 pozicione të paramasës dhe paralogarise, vlera është 78.37% më e ulët se vlera e parashikuar. Dispozitat ligjore të nenit 61 të LPP-se, parashohin një procedurë të cilën autoriteti kontraktues duhet ta zbatojë dhe në fund të konstatojë për cmimin e ofruar nga një operator ekonomik dhe nuk mund të krahasohet me vlerën e parashikuar të kontratës. Prandaj, pretendimi i OE ankues qendron.

OE ankues, në ankesën e tij, ka pretendime lidhur me ofertën e dytë pjesëmarrëse, lidhur me cmimet e ofruara, deklaratën nën betim, marrëveshjen e konzorciumit të OE BRT Pharm&Neramed. Eksperti shqyrtues, sqaron se të njëjtat pretendime edhe autoriteti kontraktues i ka çekur në letren standarde të tenderuesit të eliminuar OE BRT Pharm&Neramed, pra i njëjti është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit dhe njëherit eksperti shqyrtues, sqaron se i njëjti nuk

ka parashtruar ankese në OSHP, nuk ka shprehur interesim për këtë aktivitet të prokurimit, prandaj trajtimi i këtyre pretendimeve është i panevojshëm.

Sa i perket arsyes së dyte të eliminimit të OE ankues, i cili eliminohet me arsyetimin se:

Konstatimet nga Eksperti teknik

Përshkrimi i pretendimit

OE ankues kundërshton bazën e dytë të eliminimit – mospërbushjen e specifikimit teknik për pozicionin 68 (dezinfektues për duar me së paku 89.1 g Etanol 96% në 100 g tretësirë). Ankuesi ka ofertuar produktin "AHD 2000 G – Hygienic and Surgical Hand Disinfectant" me 75 g etanol në 100 g produkt dhe pretendon se ky produkt është ekuivalent me atë të kërkuar, duke u thirrur në vendimin paraprak të panelit shqyrtues të OSHP-së nr. 186/26 të dt. 21.04.2026, i cili e detyroi AK-në të lejojë ekuivalencën për këtë pozicion.

Në mbështetje të ekuivalencës, ankuesi paraqet ekspertizën e ekspertit gjyqësor – farmacist, specialist i toksikologjisë dhe barnave – të dt. 08.06.2026, sipas së cilës produkti i ofruar mund të konsiderohet i barasvlefshëm në aspektin teknik dhe përdorues, si dhe udhërrëfyesin e OBSH-së për higjienën e duarve, sipas të cilit formulimet me 60–80% etanol janë efektive dhe përqendrimet më të larta janë më pak potente. Ankuesi pretendon se AK ka analizuar vetëm aspektin sasior e jo atë cilësor të produktit dhe nuk e ka përfillur vendimin e OSHP-së për ekuivalencën.

Vlerësimi i ekspertit teknik

Së pari, sa i përket fuqisë së vendimit nr. 2026/0186: nga shkresat e lëndës rezulton se ai vendim e detyroi AK-në të lejojë ofertimin me produkt ekuivalent ose më të avancuar, detyrim të cilin AK e zbatoi me korrigjimin e Dosjes së Tenderit përmes formularit B54 të dt. 23.04.2026, ku për pozicionin 68 u përcaktua vlera prej së paku 89.1 g Etanol 96% në 100 g tretësirë si kërkesë minimale e pranueshmërisë. Lejimi i ekuivalencës nuk nënkupton heqjen apo uljen e minimumit të kuantifikuar; ai nënkupton se çdo produkt – pavarësisht emrit tregtar apo prodhuesit – pranohet nëse e arrin ose e tejkalon atë vlerë. Produkti i ofruar me 75 g/100 g qëndron objektivisht rreth 16% nën minimumin e kërkuar dhe, për vetë natyrën sasiore të parametrit, nuk mund të cilësohet as ekuivalent e as më i avancuar.

Së dyti, ligjshmëria e vetë specifikimit është çështje e gjykuar. Ankuesi e ka kontestuar dy herë kërkesën teknike të pozicionit 68: fillimisht me ankesën nr. 2026/0186 (e aprovuar pjesërisht, me detyrimin e lejimit të ekuivalencës, tashmë të zbatuar), e më pas me ankesën nr. 2026/0284, ku pretendoi se vlera 89.1 g favorizon një prodhues të caktuar – ankesë të cilën paneli shqyrtues i OSHP-së e refuzoi si të pabazuar, duke konfirmuar se specifikat janë minimale dhe lejojnë ofertimin me produkt ekuivalent ose më të avancuar. Në pajtim me nenin 67.1 të RRPP-së (*res judicata*), si dhe me afatin prekluziv të nenit 60.1(a) të RRPP-së për kontestimin e dokumenteve të tenderit, ankuesi nuk mund ta rihapë në fazën e vlerësimit ligjshmërinë e një specifikimi të konfirmuar nga vetë OSHP-ja.

Së treti, ekspertiza private e angazhuar nga ankuesi pas pranimit të letrës së eliminimit dhe referencat në udhërrëfyesin e OBSH-së nuk e ndryshojnë gjendjen faktike as juridike të lëndës. Asnjëra prej tyre nuk e vërteton elementin e vetëm vendimtar – se produkti i ofruar e përmbush kërkesën minimale prej 89.1 g Etanol 96% në 100 g të fiksuar në Dosjen e Tenderit. Ato, në

substancë, kontestojnë përshtatshmërinë e vetë kriterit, çështje kjo e pakohshme dhe e konsumuar sipas arsytimit më lart. Vlerësimi i ofertave bëhet ekskluzivisht ndaj kërkesave të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit (neni 40.2 dhe 40.13 i RRPP-së), e jo ndaj provave *ex post* të palëve.

Së katërti, pranimi i një produkti nën minimumin e përcaktuar do të përbënte pikërisht atë që neni 40.2 i RRPP-së e ndalon shprehimisht – ndryshimin, modifikimin apo heqjen e kërkesave të përcaktuara paraprakisht gjatë vlerësimit – si dhe trajtim të pabarabartë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së ndaj operatorëve ekonomikë të cilët nuk ofertuan ose ofertuan me produkte më të kushtueshme pikërisht për ta përmbushur minimumin. Devijimi i konstatuar përbën largim thelbësor në kuptim të nenit 40.7, nënparagrafët (i) dhe (ii) të RRPP-së, pasi dallon esencialisht nga specifikimet e dosjes së tenderit dhe afekton cilësinë e ekzekutimit të kontratës. Rrjedhimisht, konstatimi i AK-së se oferta për pozicionin 68 është e papërgjegjshme është i drejtë dhe në pajtim me nenin 40.6(b) të RRPP-së.

Mendimi I ekspertit teknik: Pretendimi është i pabazuar. Eliminimi i ofertës në bazën teknike është i ligjshëm dhe i mjaftueshëm për refuzimin e ofertës në tërësi. Rrjedhimisht, ekspertet teknik i rekomandojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE "MEDPLUS SH.P.K." të REFUZOHET si e pabazuar sa i perket specifikave teknik ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se përgjigjet në pretendime ankimore teknike janë dhënë nga eksperti teknik.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Mirepo duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, duke pasur parasysh se nuk është shkaktuar dëmtimi i buxhetit dhe po ashtu duke pasur parasysh se procedura anulohet në tërësi Paneli Shqyrtues ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet pjesërisht .

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik MEDPLUS SH.P.K . të aprovohet si pjesërisht e bazuar Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që Autoritetit Kontraktues Komuna e Pejës i mbetet në fuqi vendimi lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së” me numër të prokurimit 635-26-957-1-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat

relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - MEDPLUS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: